



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



ZYRA E KRYETARIT  
Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës nr. I-34 të dt. 25.04.2016, Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Memorandumit të Bashkëpunimit nr. II-1113 të datës 31.08.2022 në mes Komunës së Obiliqit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Kontratës për kryerjen e punëve të datës 07.09.2022, Kryetari i Komunës me datë 18.10.2022 merr këtë:

VENDIM

- I. Emërohet **Sadik Pllana** mbikëqyrës i kontratës, për kryerjen e punëve dhe shërbimeve lidhur me ndërtimin e stadiumit në Obiliq, e lidhur në bazë të Memorandumit të bashkëpunimit në mes të Komunës së Obiliqit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës.
- II. Mbikëqyrësi me përgjegjësi të plotë përcjellë punimet dhe vërteton sasisë dhe cilësinë e punëve të kryera sipas kontratës, paramasës e parallogarisë.
- III. Punët do të kryhen nga operatori ekonomik **“Invest PRO SH.P.K”**.
- IV. Punët duhet të kryhen në afat prej 60 ditëve nga dita e fillimit të punimeve, të cilat punime duhet të fillojnë brenda 3 ditësh nga hyrja në fuqi e kontratës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet :  
-Kryetarit të Komunës;  
-Menaxherit të kontratës;  
-DAP dhe DIL;  
-Arkivit.

Kryetari i Komunës  
Xhafer Gashi  
